



Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 23.03.2023, nxjerrë këtë:

V E N D I M

Mbyllet rasti AKK-DPKI-06-4554/22, për zyrtarin e lartë z. Arben Hajdari, Kryetar i Këshillit Drejtues të Muzeut Kombëtar të Kosovës, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik për z. Arben Hajdari, kryetar i Këshillit Drejtues të Muzeut Kombëtar të Kosovës, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (në vijim: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Ky rast ka filluar të trajtohet pas informatës së pranuar nga jashtë (në vijim: raportuesi i rastit), me pretendimin për konflikt të interesit të z. Arben Hajdari, gjatë ushtrimit të funksionit publik në cilësinë e kryetarit të Këshillit Drejtues të Muzeut Kombëtar të Kosovës, me rastin e publikimit të katalogut ekspozita Arkeologjike "Dardania Antike", e mbështetur financiarisht nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe ku i është dhënë e drejta autoriale me rastin e publikimit të katalogut në fjalë.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (në vijim: Agjencia), me shkresën zyrtare DPKI-06-01/4796/22, e ka njoftuar zyrtarin e lartë z. Arben Hajdari lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit dhe më pas ka organizuar dhe mbajtur një takim në zyrat e Agjencisë, me ç'rast zyrtari i lartë është njoftuar me pretendimet e raportuesit të rastit si dhe me informatat që posedon Agjencia, lidhur me këtë rast. Ndërsa, me qëllim të sqarimit të plotë të këtij rasti, Agjencia ka siguruar informacion dhe dokumentacion plotësues nga institucionet përkatëse.

Nga kërkesa e raportuesit të rastit për inicimin e procedurës së hetimit administrativ, takimet e mbajtura me zyrtarin e lartë dhe dokumentacioni i siguruar nga institucionet përkatëse, Agjencia ka konstatuar gjendjen si në vijim:

Me Vendimin nr. 680/2017, i datës 06.03.2017, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, emëron grupin punues (komisionin) përgjegjës për hartimin e Konceptit të Ekspozitës së Përherhshme në Muzeun e Kosovës, ku në mesin e anëtarëve të këtij komision është edhe prof. as. dr. Arben Hajdari;

Më 22.03.2017, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (kërkues i shërbimit), lidhë *Marrëveshje* me prof. as. dr. Arben Hajdari (ofrues i shërbimeve profesionale), lidhur me procesin e hartimit të Konceptit të Ekspozitës së Përherhshme në Muzeun e Kosovës sipas Vendimit të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit të datës 06.03.2017;

Më 23.11.2017, Muzeu i Kosovës (kërkues i shërbimit), lidhë *Marrëveshje* me prof. as. dr. Arben Hajdari (ofrues i shërbimeve profesionale), lidhur me procesin e zbatimit të Konceptit të Ekspozitës së Përherhshme në Muzeun e Kosovës sipas Vendimit të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit të datës 06.03.2017. Në nenin 3 të kësaj marrëveshje, janë caktuar përgjegjësit e ofruesit të shërbimeve, ku njëra nga ato përgjegjësi është edhe: “*Materiali për publikim*”;

Me Vendimin nr. 1183/2020, të datës 31.03.2020, Ministria e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, emëron Këshillin Drejtues të Muzeut Kombëtar të Kosovës (në vijim: KDMKK), ku në mesin e anëtarëve të këshillit është edhe prof. as. dr. Arben Hajdari;

Në vazhden e sqarimit të gjithanshëm të kësaj situate, është realizuar edhe një takim në Agjencinë me z. Arben Hajdari, ku është kërkuar sqarim veçanërisht rreth detyrave dhe përgjegjësi të tij si kryetari i KDMKK-së, mundësinë e interferimit nga kjo cilësi (përmes vendimmarrjeve apo diskutimeve), lidhur me zbatimin e marrëveshjeve të sipërcituara, ku me këtë rast, zyrtari i lartë në fjalë e ka mohuar mundësinë e çfarëdo ndërhyrjeve apo vendimmarrjeve rreth zbatimit të këtyre marrëveshjeve;

Në verifikim të këtij informacioni, Agjencia ka kërkuar nga zyra përgjegjëse në MKRS kopjet e procesverbaleve të takimeve të mbajtura të KDMKK-së, nga koha e emërimit të z. Arben Hajdari në këtë funksion, përkatësisht procesverbalet ku pikë e rendit të ditës kanë qenë, marrëveshja e lidhur më 22.03.2017, ndërmjet MKRS-së dhe Prof. as. dr. Arben Hajdari, marrëveshja e lidhur më 23.11.2017, ndërmjet Muzeut të Kosovës dhe Prof. as. dr. Arben Hajdari, si dhe, diskutime apo vendimmarrje rreth publikimit të katalogut ekspozita Arkeologjike, “Dardania Antike” e mbështetur financiarisht nga MKRS, e ku z. Arben Handarit i është dhënë e drejta autoriale me rastin e publikimit të katalogut në fjalë;

Nga përgjigja me shkrim e zyrës përgjegjëse të MKRS-së (*shkresa DPKI-06/01/628/23*) thuhet se: “*Nga të gjitha procesverbalet që posedojmë që nga emërimi i këtij Këshilli pjesë e të cilit është z. Hajdari, në asnjë procesverbal nuk kanë qenë pikat e lartcekura si pika të Rendit të Ditës*”;

Në vështrim të gjendjes faktike si më lartë, Agjencia vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, pasi që vlerësoi se ushtrimi i funksionit të kryetarit të KDMKK-së nga z. Arben Hajdari, dhe zbatimi i *marrëveshjeve* të sipërcituara nga ana tjetër, apriori nuk bie ndesh me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, pasi që është konstatuar (*shkresa DPKI-06/01/628/23*), se nga cilësia e kryetarit të KDMKK-së, nuk ka pasur asnjë diskutim apo vendimmarrje, në raport me zbatimin e këtyre marrëveshjeve.

Veç tjerash, marrëveshjet në fjalë, të lidhura në vitin 2017 (në kohën e lidhjes së këtyre marrëveshjeve z. Arben Hajdari nuk ka qenë anëtar i KDMMKK-së), mes MKRS-së, përkatësisht Muzeut të Kosovës dhe z. Arben Hajdari (tani kryetar i KDMMKK-së), nuk paraqesin konflikt të interesit në kuptim të dispozitave përkatëse të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, *përderisa* z. Arben Hajdari, në cilësi të kryetarit të KDMMKK-së nuk ndërmerr ndonjë veprim zyrtar, përkatësisht ai tërhiqet nga çdo diskutim dhe/apo vendimmarrje e KDMMKK-së, në funksion të zbatimit të këtyre marrëveshjeve.

Gjithsesi, me qëllim që edhe në të ardhmen të shmanget mundësia eventuale e konfliktit të interesit, që lidhet me çfarëdo vendimmarrje të z. Arben Hajdari në cilësi të kryetarit të KDMMKK-së, me zbatimin e marrëveshjeve në fjalë, i njëjti duhet të ketë parasysh konfliktin "rast për rast" të interesit, ashtu që është i obliguar ta deklaroj dhe të tërhiqet nga vendimmarrja, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 17, të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, si në vijim:

1. Çdo zyrtar gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vetëdeklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat ose të personave të afërm me të lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhet shkak për lindjen e një konflikti të interesit dhe të tërhiqet nga kjo vendimmarrje.

2. Deklarimi rast për rast i interesave private bëhet çdo herë nga zyrtari, kur kjo kërkohet nga udhëheqësi ose nga institucioni udhëheqës apo mbikëqyrës. Deklarimi, si rregull, duhet kërkuar dhe bërë paraprakisht. Kur kjo nuk është e mundur ose kur nuk ka ndodhur, deklarimi duhet të kërkohet të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur por jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga data e kërkesës ose e konstatimit të konfliktit të interesit.

3. Vetëdeklarimi ose deklarimi me kërkesë si rregull bëhet me shkrim, kur zyrtari përfshihet në një vendimmarrje për ndonjë çështje të caktuar. [...]

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Yll Bufeshkaj
Drejtore i Agjencisë për
Parandalimin e Korrupsionit